PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATE 29.05.2026

Sot në sallën e mbledhjeve të KB Devoll zhvillohet mbledhja e rradhës sipas njoftimit të datës 25.05.2026. Prezente në sallë:

Ilir Hoxha, Valbona Spaho, Oljana Çomka, Arsina Mazelliu, Festim Kaso, Oliver Mulla, Lindita Cokani, Alban Skoti, Vladimir Kello, Alfredi Gjata, Imelda Cucka.
Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 1. Miratimi i rendit të ditës.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes 12.05.2026.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 3, Projekt-Vendim Nr.44 Datë 21.05.2026 , " Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok ndihmën ekonomike per muajin Prill 2026.
Oliver Mulla: Janë të njëjtët njerëz që kanë qenë dhe s'jemi kundër për të marrë atë sado pak ndihmë që i ofrohet.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 4, Projekt-Vendim Nr.45 Datë 21.05.2026 , " Për miratimin e ndihmes financiare per perballimin e shpenzimeve te varrimit nga fondi rezerve i bashkise për qytetarë ne nevojë."
Oliver Mulla: Pse ka probleme me pagesat për ato që kanë kaluar?
Alfredi Gjata: Vendimi është marrë, duhet të pyesim financën.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 5, Projekt-Vendim Nr.46 Datë 21.05.2026 , "Dhënien e certifikates të mirenjohjes Z.Admir Bitincka."
Valbona Spaho: Në vitin 2024, në stinën e verës pas mbarimit të shkollës ka qenë nismëtari i parë bashkë me pjesëtarët e tjerë të familjes "Bitincka", personi në fjalë është nipi i Hasan Bitinckës, emrin e të cilit mban shkolla sot, kontribuoi financiarisht për restaurimin e tualeteve, shtrimin me pllaka të rrugës hyrëse të shkollës. Para se të kryente këto, ai ka sjellë 8 kompjutera.

Në sallë vjen këshilltari Trifon Meraku.

Oljana Çomka: Pse të mjaftohemi vetëm me certifikatë? Kërkon vlerësim më të lartë.

Vladimir Kello: Mendoj që çdo gjë që dhurohet, qoftë investim i vogël apo i madh, të futet në inventarin e shkollës apo bashkisë. Jam dakord për certifikatën, por a është bërë një preventiv nga ana e bashkisë për sa i përket investimit?
Valbona Spaho: Për sa i përket inventarizimit të kompjuterave dhe gjërave të tjera nuk mund të inventarizohen. Kam bërë inventarizim, madje kam vënë në dijeni zyrën arsimore. Çdo gjë që futet në shkollë e kam të përcaktuar me ligj.
Imelda Cuçka: Është një nga nismat e vitit 2024 për përmirësimin e shkollës "Hasan Bitincka", të dhuruara nga zotëria që mban shkollën. Valbona mund t'ja u vendosë në dispozicion.

Hapet votimi: 12 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 6, Projekt-Vendim Nr.47 Datë 21.05.2026 "Per dhënien me qira të siperfaqes 50 HA në ngastrën me kod kadastral KO02 00 019 në ekonomine kullosore "Bilisht" (Për mbarështrimin e florës së eger dhe kultivimin e bimëve të ndryshme)
Antonio Kapshtica: Bëhet fjalë për një sipërfaqe prej 50 ha kullotë, objekt i mbarështimit të florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme. Është pjesë e kufirit si vendndodhje. Nuk cenon vlerat, përkundrazi shton florën. Synimi është të gjenerojë sa më shumë të ardhura për bashkinë. Bimët që presupozohet të mbillen janë: boronica, dellinja, salep, çaj. Bëhet fjalë për firmën "MERJA"
Ilir Hoxha: Këtu thotë vlera totale 670 mijë në vit, ndërsa më poshtë thotë vlera e përdorimit të sip. lek/ha në vit 660 mijë.
Antonio Kapshtica: 1 ha është 13.200 lekë në vit.
Oliver Mulla: Do të thotë që nuk do të lejojë as kalimtarë të kalojnë aty. Sepse mund të pretendojë që e ka ai me qira.
Ilir Hoxha: A ka ndonjë tabelë fikse për çmim ha?
Antonio Kapshtica: Sipas VKM, përcaktojmë dhe vlerat.
Oliver Mulla: Do të jetë problem pasi nuk do të kalojë asnjë bagëti, pasi mund t'i dëmtojë bimët atij zotërisë. Bëhet fjalë për 50 HA.
Antonio Kapshtica: Mund t'u ofrohet me një kontratë për kullotje.
Vladimir Kello: Ka kërkesë nga qytetarë të tjerë për atë sipërfaqe?
Antonio Kapshtica: Jo, nuk ka. Sipërfaqet e tjera janë dhënë me qira.
Vladimir Kello: Është bërë thirrje publike për këtë sipërfaqe?
Antonio Kapshtica: Për atë parcelë nuk kemi asnjë kërkesë edhe pse kemi bërë mbledhje me blegtorët. Sepse edhe kundrejtimi që ka nuk është i përshtatshëm, ka pjerrësi.
Ilir Hoxha: Pavarësisht qëllimit për të cilën bashkia do ta japë këtë sip., për t'u paguar 130 mijë qira në muaj është një problem se kam debatuar dhe vjet kur u dha për parkimin e mjeteve. Me sa mbaj mend kaq i ka paguar bashkia individit për të marrë me qira.
Antonio Kapshtica: Këto tarifa për dylym apo hektarë janë të përcaktuara në VKM 559 / viti 2022.
Trifon Meraku: Mendoj që duhet të merret më shumë seriozisht zyra juaj për të ardhur këtu me një shpjegim se me të qartë që dhe ne të mos jemi skeptikë.
Imelda Cucka: Për sa i përket VKM që djali citoi, çmimi i vendosur përcaktohet për 10-vjeçarin që do të jepet. Në momentin që ne do t'ja japim me qira për 10 vite, ai mund të ketë të drejtë dhe të bëjë pjesën e investimeve të tjera apo në kontratë do përcaktohet afati kohor apo çfarë do lejoni për investim tjetër?